



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:221377

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05439179

**P.nr.88/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorit profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në çështjen penale kundër të akuzuarve: M. S. nga N., Rr. "S." nr..., Serbi, S. F. nga K. – Serbi, Rr. "R. B. 5/.." dhe B. M. gjithashtu nga N. – Serbi, Rr. " R. B. 5/.., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 parag. 1 në lidhje me nenin 31 të KP-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.581-3/17 të dt. 21.04.2017, jashtë shqyrtimit gjyqësor me datë 12.03.2024 mori këtë:**

### AKTGJYKIM

Ndaj të akuzuarve:

**1. M. S.**, nga i ati D., e lindur më dt..., në N., Rr."S." nr..., ku dhe tani jeton, ka të mbaruar arsimin e mesëm, i pa martuar, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, serbe, shtetas i Republikës së Serbisë.

**2. S. F.**, nga i ati B., i lindur më dt..., në N., Rr. "R. B. 5/.." ku dhe tani jeton me profesion taksist, serb, shtetas i Republikës së Serbisë.

**3. B. M.**, nga i ati J., e lindur më dt..., në N., Rr." R. B. 5/..", ku dhe tani jeton, ka të mbaruar arsimin e mesëm, i pa punë, serb, shtetas i Republikës së Serbisë.

**Në bazë të nenit 362 pika 1.3. të KPPK-së,**

### REFUZOHET AKUZA

Me datë 01.03.2017, në Dragash, të pandehurit në bashkëveprim e me qëllim të fitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo tjetrin, mashtrojnë dhe i vënë në lajthim qytetarët dhe me këtë i shtynë të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, duke vepruar në atë mënyrë që të njëjtit paraqitën si anëtarë të shoqatës humanitare "D. O.", me seli në N. të Serbisë, për të mbledhur fonde kinse për aktivitet humanitar ku qytetarëve iu ofronin një kartolinë dhe pasi merrnin paratë nga ta iu jepnin një deftesë të vulosur me vulën e organizatës së lartëcekur.

**- Me këto veprime në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale mashtrimi, nga neni 335 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.**

**- Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.**

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.581-3/2017 të dt. 21.04.2017, me të cilën ka akuzuar të pandehurit: M. S. nga N., Rr. "S." nr..., Serbi, S. F. nga K. – Serbi, Rr. "R. B. 5/.." dhe B. M. gjithashtu nga N. – Serbi, Rr. "R. B. 5/..", se kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale mashtrimi nga neni 335 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Fillimishtë kjo gjykatë ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 20.09.2021 ku ka prezentuar vetëm e pandehura M. F. e cila ka pranuar fajësinë sipas Aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr.55/17 të dt. 20.09.2021 dhe është veçuar procedura për të akuzuarit tjerë e që janë pjesë e kësaj lende.

Kjo gjykatë më pastaj ka provuar disa herë që të ftojë të pandehurit mirëpo duke patur parasysh se kanë qenë shtetas të huaj (serbë) ka qenë e pamundur të sigurohet prezenca e tyre, ndërsa ka ndërmarrë disa veprime procedurale edhe atë: me datë 04.08.2021 ka lëshuar Urdhër-arrest ndaj të njejtëve e gjithashtu edhe e ka pazulluar procedurën në kuptim të nenit 285 par. 4 lidhur me nenin 157 par. 1 të KPPRK-së, mirëpo ka qenë e pamundur sigurimi i prezences së të akuzuarve të cituar.

Gjithashtu më pastaj gjykata duke shqyrtuar aktakuzën, e veqanërishtë kohën e kryerjes së veprës penale (edhe atë dt. 01.03.2017) si dhe afatit për parashkrim të kësaj vepre (gjashtë vite), ka ardhur në përfundim se ka kaluar afati absolut i parashkrimit të ndjekjes për këtë vepër penale, të paraparë me nenin 106 par.1 pika 1.5 të KPK-së dhe nenit 107 par.8 i KPK-së.

Meqenëse ka kaluar afati i parashkrimit i paraparë me dispozitat e lartëcekura, gjykata konform nenit 362 pika 1.3 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në përputhje me nenin 453 par.1 të KPPK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2021:221377, 12.03.2024**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.